



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE LOKALE TE SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënie e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin nr. 2, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 20, datë 05.02.2021 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit programi audioviziv”, **në muajin mars 2021**, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së aplikimeve për dhënie e licencës të shërbimit të programit audioviziv, si më poshtë:

1. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv, në Qarqet Fier dhe Vlorë.

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit
1.	Qarqet Fier dhe Vlorë	Ofrues shërbimi programi audioviziv i përgjithshëm

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II", Kutia Postare 1010, Tiranë, brenda **datës 29 mars 2021, ora 10:00**.

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënie e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 16.01.2020, ku përfshihen kërkesat ligjore, ekonomike, teknike, programore etj.
- Pagesat për licencë.

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimi për licencë shërbim programi konsiderohet edhe kërkesë për marrjen e Numrit Logjik të Programit (NLP), i cili do të jepet me vendim të AMA-s, në segmentin e caktuar për kategorinë përkatëse të programit.

Aplikimet do të hapen më datë 29 mars 2021, ora 10:00, në mjediset e AMA-s ku aplikuesit apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.